

Realizimi hetimeve dhe monitorimeve nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve të Shërbimeve/Jo Prodhuese gjatë periudhës Maj-Shtator 2019

Hetime

1. Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 564, datë 25.10.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, për të vlerësuar nëse ka sjellje antikonkurruese në kuptim të nenit 9 të Ligjit 9121/2003. Procedura e Hetimit Paraprak e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës përfshin periudhën 2015-2018. Nga analiza e sjelljes së FSHF në tregjet përkatëse konstatohen shënja të cilat mund të kufizojnë konkurrencën në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43 të Ligjit Nr 9121 datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar me ***Vendimin Nr. 607, Datë 01.04.2019*** ka hapur procedurën e hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon. Dorëzimi i raportit me gjetjet përkatëse është realizuar.
2. Komisioni i Konkurrencës me ***Vendimin Nr. 574, datë 26.11.2018*** “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira” vendosi Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira (shërbimin e noterisë, avokatisë dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme). Arsyeja e hetimit është fakti se Tregu i Profesioneve të Lira, si treg i rregulluar, mund të paraqesë kufizime në hyrjen dhe sjelljen profesionale, prandaj Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me Rregullatorët, Shoqatat, ka mbledh informacione dhe ka analizuar nëse ka kufizime lidhur me kuadrin rregullator, hyrjen dhe sjelljen profesionale, heqja e kufizimeve të pa nevojshme, informimin e blerësve të pa informuar, të drejtat ekskluzive. Dorëzimi i raportit me rekomandimet përkatëse është realizuar.
3. Komisioni i Konkurrencës me ***Vendimin Nr. 609, Datë 10.04.2019*** vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës” pasi janë paraqitur disa ankesa dhe kërkesa të cilat konsistojnë në sjelljen e operatorëve të shërbimit taksi në qytetin e Tiranës, lidhur me caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi në qytetin e Tiranës. AK është duke ndjekur procedurën nëpërmjet kerkimit të informacionit në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) nga Bashkia e Tiranës e cila licenson këtë aktivitet dhe të tjera institucione si Drejtoria e Kolaudimit te taksimetrave që janë pjesë e këtij procesi për të vlerësuar sjelljet e ndërmarrjeve me pozitë dominuese, të cilat mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me pasoja për konkurrencën në treg.

Gjatë procedurës hetimore, për shkak të mos sigurimit të përgjigjeve nga institucionet në formën e kërkuar, për të proceduar me marrjen e informacionit lindi nevoja për hetime të mëtejshme, prova dhe të dhëna shtesë nga institucionet. Për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 639, Datë 18.07.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës” vendosi ndryshimin e vendimit në mënyrë që Raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 14 Tetor 2019. Pritet shtyrje e vendimit pasi institucionet nuk kanë dërguar ende të dhëna të sakta të vlefshme për hetimin.

4. Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 516 datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në Sektorin Bankar”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo, e cila ka përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrojnë këto banka për të vlerësuar nëse ka sjellje antikonkurrese në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit 9121/2003. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë vënë re shënja të kufizimit të konkurrencës për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43 të Ligjit Nr 9121 datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me Vendimin Nr. 592, Datë 31.01.2019 ka hapur procedurën e hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo. Koha e mbetur në dispozicion nga momenti i depozitimit të informacionit është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2018 kështu që Komisioni i Konkurrencës me **Vendimin Nr. 642, datë 25.07.2019** “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”” vendosi për zgjatjen e periudhës hetimore. Kjo procedurë është në fazën e përpunimit të informacionit të administruar dhe hartimit të raportit me gjetjet e hetimit.
5. Komisioni i Konkurrencës, me anë të **Vendimit Nr. 623, datë 23.05.2019** “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit Nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”, i cili ishte në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka realizuar monitorimin e këtij tregu, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Në përfundim të periudhës së monitorimit Komisioni Konkurrencës vendosi për monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të

sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020 si dhe detyrimin e AMF për të parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo rast që pengon, kufizon, apo shtrembëron konkurrencën, në lidhje me tregun e shitjes së policës - kartoni jeshil.

6. Komisioni i Konkurrencës, me anë të **Vendimit Nr. 634, datë 04.07.2019** “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare” pasi vlerësoi dokumentin për këshillim publik të miratuar me vendimin e Këshilli Drejtues të AKEP Nr. 10, datë 17.04.2019 “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare” vendosi për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si vijon:

- i. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- ii. Vendosjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
- iii. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.

7. Komisioni i Konkurrencës, me anë të **Vendimit Nr. 635, datë 04.07.2019** “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare” pasi vlerësoi dokumentin për këshillim publik të miratuar me vendimin e Këshilli Drejtues të AKEP Nr. 11, datë 17.04.2019 “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” vendosi për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si vijon:

- i. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse.
- ii. Sjelljen në vëmendje të zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 568, datë 15.11.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”:
 - Të vendosë nën rregullim tarifatat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me

- shumicë të akses-origjinimit, për nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg, pa pritur rezultatet e rregullimit të tarifave të tregut të akses – origjinimit;
- Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si: i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve; ii. Tarifatat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
 - Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.
- iii. Sjelljen në vëmendje të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, në pikën 1.3.e të tij i është rekomanduar AKEP, si vijon:
- a. Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.
- iv. Autoriteti i Konkurrencës i kërkon AKEP që në bazë të nenit 70 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 38 të ligjit “Për komunikimet elektronike” të vërë në dispozicion të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese ose sjelljet e koordinuara të përshkruar në dokument. Ky informacion do të mundësonte hapjen ose jo të procedurave hetimore të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- v. Monitorimin e tregut të telefonisë celulare për një periudhë 6 (gjashtë) muaj nga dalja e këtij vendimi.
8. Komisioni i Konkurrencës, me anë të **Vendimit Nr. 637, datë 09.07.2019** “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit Nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme” i cili ishte në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme ka realizuar monitorimin e këtij tregu, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Në përfundim të periudhës së monitorimit Komisioni i Konkurrencës vendosi: t’i kërkojë AMF zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018, brenda një periudhe 6 mujore. Të raportojë pranë AK për përmbushjen e rekomandimeve; Monitorimin e sjelljes së shoqërive të sigurimit në tregun e TPL, pas përcaktimit të primeve të rrezikut nga AMF të ndryshme për çdo shoqëri sigurimi, duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019; Monitorimin e sjelljes së shoqërive të brokerimit dhe shoqërisë “Star Broker” të licencuar nga AMF si ndërmjetës në sigurime duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019.

Monitorime

1. Komisionit të Konkurrencës me **Vendimin Nr. 560, Datë 15.10.2018** vendosi “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve Ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, për të shmangur çdo kufizim të konkurrencës nga aplikimi i përcaktimi i çmimeve të rishitjes, duhet të marrë masat si vijon: a) të mos aplikojë në faturat e shitjeve (brenda sistemit softëare dhe jashtë sistemit softëare), çmime të këshilluara dhe marzhin teorik; b) të mos monitorojë çmimet e rishitjes, për të shmangur çdo sjellje antikonkurrese lidhur me mbajtjen e çmimit të rishitjes apo koordinimin e sjelljes për fiksimin e çmimit përfundimtar të shitjes; c) brenda 60 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi të informojë Autoritetin e Konkurrencës lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimit të mësipërm si edhe monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për një periudhë 1 vjeçare. AK ka dërguar shkresa për dozëzimin e faturave dhe monitorim në terren për këtë qëllim dhe ka hartuar relacionin përkatës dhe është në pritje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës pasi ky monitorim përfundon në Tetor 2019.
2. Vleresimi i informacionit të ndërmarrjes Cineplex në zbatimin e **Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 479, datë 26.10.2017** “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës”. AK ka dërguar shkresa në drejtim të ndërmarrjes Cineplex dhe është në pritje të administrimi i informacionit dhe përgatitjen e relacionit lidhur me sjelljen dhe rekomandimet e dhëna nga AK brenda muajit Tetor 2019.
3. Komisioni i Konkurrencës me anë të **Vendimit Nr. 562, datë 25.10.2018**, Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”, ka kërkuar informacion nga ndërmarrja SGS për QKTL-të. Autoriteti i Konkurrencës ka kryer monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr.562, datë 15.10.2018, nëpërmjet inspektimit dhe dërgimit të shkresave në MIE. Është hartuar relacioni dhe draft projekt vendimi mbi të cilën Komisioni i Konkurrencës ka marrë Vendimin Nr. 645 datë 31.07.2019 në zbatim të nenit 69 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” për të kërkuar liberalizimin e tregut duke qënë se Kontrata e Koncensionit “Për shërbimin e kontrollit teknik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, përfundon në 03.09.2019.
4. **Monitorim i Tregut të transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.** Në vazhdim të detyrave të lëna me Vendimin Nr. 525, datë 14.06.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe

dhënien e disa rekomandimeve”, drejtoria ka vijuar me monitorimin e tregut të transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines. Monitorimi konsiston në raportimin e Austrian Airlines pranë Autoritetit të Konkurrencës çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar, numrin e ankesave që ka patur, raste të overbooking, për një periudhë 1 vjeçare. Dorëzimi i raportit pas përfundimit të periudhës së monitorimit është realizuar.

5. **Monitorimi i tregut të sigurimit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme** në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”. Monitorimin e sjelljes së shoqërive të sigurimit në tregun e TPL, pas përcaktimit të primeve të rrezikut nga AMF të ndryshme për çdo shoqëri sigurimi, duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019. Monitorimin e sjelljes së shoqërive të brokerimit dhe shoqërisë “Star Broker” të licencuar nga AMF si ndërmjetës në sigurime duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019.
6. **Monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil**, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.
7. **Monitorimin e tregut të telefonisë celulare për një periudhë 6 (gjashtë) mujore**, në zbatim të Vendimit Nr. 635, datë 04.07.2019 Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”.

Vlerësime ankesash

1. **Z. Artan Zhiva me anë të shkresës së Nr. 224/3 Prot., datë 05.07.2019** ka depozituar një ankesë, lidhur me shkresën tonë Nr. 224/2, datë 15.05.2019, për disa praktikave tregtare abuzive të shoqërisë Albtelecom në zonën e Pogradecit. Pas vlerësimit të ankesës Autoriteti i Konkurrencës do të mbajë nën monitorim tregun me pakicë të aksesit broadband për të kryer një vlerësim më të plotë të ankesës së Z. Artan Zhiva kundrejt ndërmarrjes “Albtelecom” SHA.
2. **Z. Ndue Prifti me anë të postës elektronike (e-mail)** ka depozituar një ankesë, protokolluar me Tonën Nr. 371 Prot, datë 12.06.2019, lidhur lidhur me ndryshimin që tre kompanitë celulare kanë kryer muajin e fundit në lidhje me vlefshmërinë e kreditit për numrat me rimbushje duke zbritur atë nga 6 në 1 muaj. Gjithashtu shprehet se nëse kryhet një rimbushje prej p.sh. 200 lekë, kjo vlerë zerohet automatikisht pas 1 muaji. Ajo që vihet re është që kompanitë e kanë kryer këtë ndryshim njëkohësisht në dëm të abonentëve duke detyruar abonentët të shpenzojnë këtë kredit me aktivizimin e ofertave. Nisur nga objekti i ankesës, dhe për një vlerësim sa më

të drejtë të kërkesës së ankimesit, i është kërkuar plotësimi i Formularit-Tip të Ankesës, ku të përmbajë midis të tjerave: pretendimet për kufizimet ose shkeljet e dyshuara të konkurrencës ndaj tij, ose subjekteve të tjera; përshkrimi i fakteve të cilave u referohet; renditjen e provave të shkeljes së dyshuar që ai disponon. Ankimesi nuk u paraqit për ta plotësuar këtë formular.

3. **Znj. Franceska Mullaj me anë të postës elektronike** (e-mail) ka depozituar një ankesë, protokolluar me Tonën Nr. 402 Prot, datë 24.06.2019, lidhur me faktin që operatorët ofrojnë oferta të njëjta me të dy numrat që ajo disponon si Vodafone dhe Albtelecom dhe në këtë mënyre nuk ka mundësi zgjedhje të një operatori celular me oferta më të mira. Nisur nga objekti i ankesës, dhe për një vlerësim sa më të drejtë të kërkesës së ankimesit, i është kërkuar plotësimi i Formularit-Tip të Ankesës, ku të përmbajë midis të tjerave: pretendimet për kufizimet ose shkeljet e dyshuara të konkurrencës ndaj tij, ose subjekteve të tjera; përshkrimi i fakteve të cilave u referohet; renditjen e provave të shkeljes së dyshuar që ai disponon. Ankimesi nuk u paraqit për ta plotësuar këtë formular.
9. **Vlerësimi i njoftimit të vendimit Nr. 47 datë 27.03.2019 të ERE** për ndryshime të kërkuara nga OST SH.A, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.A. Pas vlerësimit vendimit të bordit të ERE për këto ndryshime AK është shprehur se gjatë procedurës së aplikimit për çertifikim të OST-së, ERE ka dërguar draft aktet nënligjore përkatëse, për të cilat AK ka shprehur opinionin bazuar në ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, ku vendim nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.
10. **Në lidhje me vendimin e ERE Nr. 53, datë 03.04.2019** mbi fillimin e procedurës për miratim të “Rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror, AK ka realizuar vlerësimin e këtij njoftimi të vendimit në të cilin nuk konstatohen masa apo praktika të cilat bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
11. **Në lidhje me vendimin e ERE Nr. 54, datë 03.04.2019** mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e “Planit të Investimeve për vitin 2019, për Shoqërinë OST SHA”. AK ka realizuar vlerësimin e këtij njoftimi të vendimit nuk është publikuar Plani i Investimeve për vitin 2019, në mënyrë që të sigurohet një analizë e saktë lidhur me planifikimin më të drejtë të shërbimeve të ofruar, në të cilin nuk konstatohen masa apo praktika të cilat bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
12. **Në lidhje me vendimin Nr. 56, datë 03.04.2019 të bordit të ERE** “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin Nr.2018/06/PHGI-EnC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”, propozuar nga Operatori i Kombinar i Gazit Natyror Albgaz SHA”. AK ka realizuar vlerësimin e këtij njoftimi të vendimit në të

cilin nuk konstatohen në parim masa apo praktika të cilat bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

13. ***Në lidhje me vendimin Nr. 57, datë 15.04.2019 të bordit të ERE*** “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin a, b, c dhe d, sipas vendimit të ERE Nr. 129, datë 04.06.2018, “Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”. AK ka realizuar vlerësimin e këtij kodi i cili është në përputhje me parimet e konkurrencës si dhe në përshtatje të plotë të direktivave të Komisionit Europian, pra nuk bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
14. ***Në lidhje me Vendimin Nr. 58, datë 15.04.2019 të bordit të ERE*** për “Miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) SHA dhe furnizuesit”, AK ka realizuar vlerësimin e këtij njoftimi të vendimit në të cilin nuk konstatohen masa apo praktika të cilat bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
15. ***Në lidhje me vendimin e Bordit të ERE Nr. 68, datë 15.05.2019*** “Mbi miratimin e draft kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH SHA dhe OSHEE SHA për periudhën 01.03.2019 – 31.12.2019. AK ka realizuar vlerësimin e këtij njoftimi të vendimit në të cilin nuk konstatohen në parim masa apo praktika të cilat bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
16. ***Në lidhje me vendimin Nr. 84, datë 31.05.2019 të bordit të ERE*** “Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese)të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019 midis OST SHA dhe KESH SHA, AK pas vlerësimit të vendimit lidhur me kontratën dhe rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” konstaton se nuk bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
17. ***Në lidhje me vendimin Nr. 85, datë 31.05.2019 të bordit të ERE*** mbi miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A,B,C dhe D sipas vendimit të ERE Nr. 129, datë 04.06.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”. AK pas vlerësimit të këtij vendimi është shprehur që ky draft propozim nuk bie në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
18. ***Në lidhje me vendimin Nr. 88, datë 31.05.2019 të bordit të ERE*** “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të rregullores së

Komisionit(BE) 2015/1222 të datës 24.07.2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e Kongjestioneve” për shoqërinë OST SHA”. Pas vlerësimit të këtij vendimi nga AK rezulton se ky propozim është në përputhje me parimet e konkurrencës si edhe në përshtatje të plotë të direktivave të Komisionit European, pra nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

19. ***Në lidhje me vendimin e ERE Nr.90, datë 31.05.2019*** mbi fillimin e procedurës për “Miratimin e kontratës tip ndërmjet KESH SHA dhe OSHEE SHA për shit-blerjen sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019”. AK vlerësoj vendimin dhe konsttaon se zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, konkretisht të KESH SHA dhe OSHEE SHA është në kompetencën e ERE si rregullator, procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes është e parashikuar në nenin 24 të këtij ligji, pra në parim ky vendim nuk bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
20. ***Në lidhje me vendimin e ERE Nr.91, datë 31.05.2019*** mbi një ndryshim në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE”SHA dhe furnizuesve të energjisë elektrike” AK vlerëson se në parim ky ndryshim nuk bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
21. ***Në lidhje me vendimin e ERE Nr. 98, datë 21.06.2019*** mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Planit të Investimeve të OSHEE SHA, për vitin 2019 dhe përditësimin e planit të zhvillimi të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare”. AK pas vlerësimit të këtij njoftimi konstaton se ky vendim nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
22. ***Në lidhje me vendimin e ERE Nr. 100, datë 21.06.2019*** mbi miratimin e “Rregullores për caktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”. AK është shprehur me shkresën Nr.258/1 prot, datë 08.05.2019 që kjo draft rregullore për kriteret standarte minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror e publikuar, në parim nuk bie në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
23. ***Në lidhje me vendimin Nr. 102, datë 26.06.2019 të bordit të ERE*** mbi miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Europës Kontinentale për karakteristikat shtesë të rezervave të mbajtjes së frekuencës (FCR) në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017 që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të Energjisë Elektrike”. AK pas vlerësimit të vendimit është shprehur se draft-Propozimi i të gjitha OST-ve, të Europës Kontinentale, për karakteristikat shtesë të rezervave të mbajtjes së frekuencës (FCR), që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të

transmetimit të Energjisë Elektrike”, nuk bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

24. **Në lidhje me vendimin Nr. 103, datë 26.06.2019 të bordit të ERE** mbi miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin NR.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”. AK pas vlerësimit të aktit “Transpozimi i rregullores 2017/459 të miratuar me Vendimin Nr. 2018/06/ PHLG-EnC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”, pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores të Bashkimit Europian (EU) Nr.2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bërë, nuk bie në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

25. **Në lidhje me vendimin e ERE Nr. 117, datë 22.07.2019** mbi miratimin e një ndryshimi në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” SHA dhe furnizuesve të energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr.24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin Nr. 58, datë 15.04.2019. AK lidhur me vlerësimin e aktit është shprehur që ky ndryshim në marrëveshje për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” SHA dhe furnizuesve të energjisë elektrike, në parim nuk bie në kundërshtim me ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

26. **Vlerësimi i projekt akteve të dërguara nga ERRU-ja** për miratimin e nivelit të tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, për ndërmarrjet :

- **UK Tropojë**, pas shqyrtimi dhe vlerësimit të informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Tropojë SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit që të bëjë sa më transparente subvencionet që do të përfitojë për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore; Tarifatat të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet: ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 628, datë 13.06.2019 të Komisionit të Konkurrencës për UK Tropojë.
- **UK Lushnjë**, pas shqyrtimi dhe vlerësimit të informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Lushnjë SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit që të bëjë sa më transparente subvencionet që do të përfitojë për mbulimin e kostove,

si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore; Tarifatat të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet: ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 629, datë 20.06.2019 të Komisionit të Konkurrencës për **UK Lushnjë Sha.**

- **UK Malësi e Madhe Sha**, pas shqyrtimi dhe vlerësimit të informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë **Malësi e Madhe SHA**”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit që të bëjë sa më transparente subvencionet që do të përfitojë për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore; Tarifatat të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet: ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 630, datë 20.06.2019 të Komisionit të Konkurrencës për **UK Malësi e Madhe Sha**